



## **Përmbajtja**

1. Parathënie
2. Metodologjia për përgatitjen e analizës
3. Legjislacioni dhe zbatimi i çështjeve gjinore dhe aspektit të aftësisë së kufizuar
4. Korniza strategjike dhe programore si dhe raporte mbi përfshirjen gjinore dhe aspektit të aftësisë së kufizuar
5. Të gjeturat kryesore
6. Rekomandimet
7. Referencat dhe burimet e informacionit

## Parathënie

Në kontekstin e Kosovës, integrimi dhe përfshirja e personave me aftësi të kufizuara mbetet një sfidë e rëndësishme që kërkon një vëmendje të veçantë, veçanërisht kur kjo përfshirje shihet nga një perspektivë gjinore. Në një periudhë ku angazhimet për drejtësi dhe barazi janë në qendër të agjendës politike dhe sociale, është jetike të shqyrtojmë në thellësi se si politika dhe legjislacioni i Kosovës adresojnë sfidat e personave me aftësi të kufizuara, veçanërisht nga një perspektivë gjinore. Ky dokument paraqet një analizë të detajuar mbi mënyrën se si perspektiva e aftësisë së kufizuar dhe ajo gjinore ndërveprojnë dhe ndikojnë në ndihmën dhe mbrojtjen e grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara në Kosovë.

Tema e aftësisë së kufizuar dhe perspektivës gjinore në Kosovë është një çështje thelbësore për t'u trajtuar për shkak të kompleksitetit dhe sfidave të shumta që përfshijnë. Gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara në Kosovë përballen me një formë të dyfishtë diskriminimi: si për shkak të gjinisë së tyre, ashtu edhe për shkak të aftësisë së kufizuar. Gratë në zona rurale, me aftësi të kufizuara dhe të pakicave etnike (veçanërisht boshnjakët, romët, ashkalinjtë dhe egjiptianët) shpesh përballen me barriera dhe pabarazi të shtuara.<sup>1</sup> Ky diskriminim i dyfishtë krijon barriera të shumta në qasjen e tyre në arsim, punësim, shërbime shëndetësore dhe pjesëmarrje sociale. Përmirësimi i politikave dhe legjislacionit në këtë fushë është thelbësor për të siguruar që të drejtat dhe nevojat e këtyre individëve të jenë të mbrojtura dhe të respektohen përmes përfshirjes së perspektivës gjinore në praktikë.<sup>2</sup> Për një shoqëri si Kosova, e cila është në proces

---

<sup>1</sup> Plani i Veprimit Gjinor III – 2021-2025 Plani i Zbatimit në Nivel Vendi për Kosovën

<sup>2</sup> Përfshirja e perspektivës gjinore në praktikë-Udhëzues, Qendra Kosovare për Studime Gjinore, me përkrahje të projektit "Përkrahje Partnerëve Social", i mbështetur nga BE;

të vazhdueshëm të zhvillimit dhe demokratizimit, trajtimi i drejtë dhe përfshirës i këtyre çështjeve është vendimtar për përparimin e gjithëmbarshtëm social dhe ekonomik. Analiza e kësaj teme në një kontekst të tillë është thelbësore për të identifikuar dhe adresuar mangësitë aktuale, dhe për të zhvilluar rekomandime që do të ndihmojnë në krijimin e një mjedisi më gjithëpërfshirës dhe më të drejtë.

Qeveria ka hartuar dhe miratuar ligje dhe politika, që synojnë përmirësimin e kushteve dhe mundësive për personat me aftësi të kufizuara, si dhe ka zhvilluar strategji për të luftuar diskriminimin dhe për të siguruar mbrojtjen e të drejtave të tyre dhe për të garantuar të drejtat dhe barazinë për të gjithë qytetarët, përfshirë ata me aftësi të kufizuara. Megjithatë, përpjekjet për të përfshirë perspektivën gjinore në këto politika dhe legjislacion janë ende në zhvillim e sipër. Shumica e qytetarëve, theksueshëm gratë, nuk marrin pjesë në përcaktimin e krijimit të buxheteve edhe pse Ligi Nr. 05/L-020 për Barazi Gjinore<sup>3</sup> detyron të gjitha institucionet publike që të sigurojnë përfaqësim të barabartë gjinor, duke përfshirë edhe pozitat udhëheqëse. Ai kërkon *“buxhetim të përgjegjshëm gjinor”*<sup>4</sup> dhe *“integrim gjinor”*<sup>5</sup> në të gjitha politikat institucionale. Kjo nënkupton përfshirjen e perspektivës gjinore *“në çdo fazë të procesit, planifikimit, miratimit, zbatimit, monitorimit dhe vlerësimit të legjislacionit, politikave apo programeve dhe buxheteve në të gjitha fushat politike dhe sociale”*. Kjo mangësi ndodh për shkak se krijimi i buxhetit konsiderohet si temë shumë teknike e cila 'më së miri është t'iu lihet

---

<sup>3</sup> Ligji Nr. 05/L-20 për Barazinë Gjinore-Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/ Nr. 16.

<sup>4</sup> Buxhetimi gjinor është zbatimi i integritit gjinor në procesin buxhetor.

<sup>5</sup> Integrimi gjinor është procesi i vlerësimit të implikimeve për burrat dhe gratë në çdo veprim të planifikuar, përfshirë legjislacionin, politikat ose programet, në të gjitha fushat dhe në të gjitha nivelet.

ekspertëve'," gjë që ndikon negativisht tek gratë me aftësi të kufizuara, pasi nevojat e tyre specifike shpesh injorohen në planifikimin dhe ndarjen e fondeve publike.<sup>6</sup>

Qëllimi është të krijojmë një pasqyrë të qartë të sfidave dhe nevojave të veçanta të grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara dhe të propozojmë rekomandime për të avancuar mbrojtjen dhe përfshirjen e tyre në të gjitha nivelet e shoqërisë kosovare. Angazhimi si shoqëri duhet të rritet në drejtim të kontribuit në forcimin e politikave dhe praktikave që do të sigurojnë një shoqëri më të drejtë dhe më të barabartë për të gjithë, pa marrë parasysh aftësitë fizike ose përkatësinë gjinore. Angazhimi për të adresuar këto çështje është një hap i rëndësishëm drejt krijimit të mundësive të barabarta për të gjithë qytetarët e Kosovës.

## **Metodologjia**

Analiza synon të shqyrtojë ligjet e Kosovës në lidhje me aftësinë e kufizuar nga një këndvështrim gjinor, me qëllim identifikimin e mangësive dhe ofrimin e rekomandimeve për përmirësimin e tyre për të siguruar mbrojtje dhe përfshirje të barabartë për gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara. Ligjet dhe strategjitë në shqyrtim përfshijnë Ligjin për Barazi Gjinore, Ligjin për Statusin dhe të Drejtat e Personave Paraplegjik dhe Tetraplegjik, Ligjin për Aftësimin dhe Punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara, Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Programin e Kosovës për Barazi Gjinore 2020-2024, Strategjinë Kombëtare për Mbrojtje nga Dhuna në Familje dhe Dhuna ndaj Grave 2022 – 2026 si dhe Raportet e fundit të Progresit për Kosovën.

---

<sup>6</sup> Manuali për vlerësimin e ndikimit të barazisë gjinore, Agjencia për Barazi Gjinore, Projekti "Forcimi institucional i Agjencisë për Barazi Gjinore dhe mekanizmave gjinore në Kosovë";

Përmbledhja e ligjeve dhe dokumenteve strategjike fillon me një rishikim të hollësishëm për të kuptuar masat dhe aspekte gjinore që prekin personat me aftësi të kufizuara. Ky hap ndihmon në identifikimin e mekanizmave dhe masave të vendosura për mbrojtje dhe përfshirje.

Në vazhdim, analizohen dispozitat ligjore për të vlerësuar përfshirjen e barazisë gjinore dhe personave me aftësi të kufizuara. Pjesa tjetër e analizës fokusohet në integrimin e perspektivës gjinore, duke shqyrtuar diskriminimin e dyfishtë dhe vlerësuar pjesëmarrjen dhe përfaqësimin e grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara në proceset vendimmarrëse dhe zbatimin e masave.

Rekomandimet për përmirësime bazohen në analizën e mangësive të identifikuara, duke përfshirë krijimin e propozimeve dhe sugjerimin e mekanizmave të veçantë për implementimin efektiv të politikave dhe ligjeve që ndihmojnë në mbështetje të plotë për këtë grup të popullatës.

Metodologjia përfshin analiza dokumentare për të identifikuar dispozitat dhe qëllimet e lidhura, si dhe vlerësimin e praktikave të zbatimit për të parë ndikimin në përfshirjen e grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara.

Kjo metodologji do të ofrojë një analizë të thelluar dhe gjithëpërfshirëse të ligjeve dhe politikave, duke ndihmuar në zhvillimin e politikave dhe praktikave që sigurojnë barazi dhe përfshirje të plotë.

### 3. Legjislacioni dhe zbatimi i çështjeve gjinore dhe aspektit të aftësisë së kufizuar

#### 3.1 Ligji Nr. 05/L-020 për Barazi Gjinore në Kosovë

Ligji Nr. 05/L-020 për Barazi Gjinore është një hap i rëndësishëm në drejtim të sigurimit të barazisë gjinore dhe eliminimit të diskriminimit në të gjitha fushat e jetës. Ky ligj synon të sigurojë mundësi dhe trajtim të barabartë për të gjithë individët, pavarësisht nga gjinia apo seksi, duke përfshirë në mënyrë të zbehtë edhe personat me aftësi të kufizuara. Përkatesisht, në Nenin 4 të këtij Ligji ceket se *"Ndalohet diskriminimi i drejtpërdrejtë apo i tërthortë gjinor, duke përfshirë trajtimin më pak të favorshëm të femrave për shkak të shtatzënisë dhe amësisë, gjendjes martesore, kombësisë, racës, **aftësisë së kufizuar**, orientimit seksual, statusit social, besimit fetar dhe besimit, moshës, ose ndonjë baze tjetër të përcaktuar me ligj apo marrëveshje dhe instrumente ndërkombëtare në fuqi."*<sup>7</sup> Mirëpo, Neni 4, Pika 1, është i vetmi rast kur termi "aftësi e kufizuar" përmendet në Ligjin Nr. 05/L-020 për Barazi Gjinore. Në këtë analizë, do të shqyrtojmë dispozitat kryesore të këtij ligji, do të vlerësojmë se si ai trajton çështjet që lidhen me personat me aftësi të kufizuara dhe do të japim rekomandime për përmirësime të mundshme.

Ligji përcakton qëllimet dhe principet bazë për arritjen e barazisë gjinore, duke përfshirë promovimin e pjesëmarrjes së barabartë në të gjitha fushat e jetës publike dhe private. Një nga aspektet kryesore të ligjit është ndalimi i diskriminimit në bazë të gjinisë në punësim, arsim, shëndetësi, ekonomi, përfitime sociale, sport dhe kulturë. Ligji synon të sigurojë që gratë dhe burrat të kenë të drejta dhe mundësi të barabarta.

---

<sup>7</sup> Ligji Nr. 05/L-020 për Barazi Gjinore në Kosovë

Edhe pse ligji paraqet disa aspekte pozitive në përpjekjet për të promovuar barazinë gjinore në vendin e punës, ai ka disa mangësi të dukshme që ndikojnë në efektivitetin e tij për përfshirjen e personave me aftësi të kufizuara, veçanërisht në lidhje me dimensionin gjinor.

Një nga aspektet më të rëndësishme të ligjit është kërkesa për punëdhënësit që të sigurojnë kushte të barabarta pune për gratë dhe burrat dhe të marrin masa për të parandaluar diskriminimin gjinor. Ky fokus është i rëndësishëm dhe i nevojshëm, por ai gjithashtu duhet të përfshijë një dimension të veçantë që adreson ndërveprimin e barazisë gjinore me nevojat e personave me aftësi të kufizuara.

Në këtë kontekst, ligji kërkon masa për të siguruar qasje të barabartë në punësim dhe trajnime profesionale, por nuk ofron udhëzime të qarta dhe mekanizma specifike për të siguruar përfshirjen e personave me aftësi të kufizuara. Kjo do të thotë se, ndonëse ligji synon të promovojë barazinë gjinore dhe të ndalojë diskriminimin në përgjithësi, ai nuk e adreson në mënyrë të mjaftueshme se si këto masa ndihmojnë në mënyrë të barabartë gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara në vendin e punës dhe në trajnime profesionale.

Mangësia e detajeve specifike është e dukshme kur e konsiderojmë se vajzat dhe gratë me aftësi të kufizuara shpesh përballen me barrierat më të mëdha për qasje në mundësi të barabarta në punë dhe trajnim. Këto barrierë janë të kombinuara nga dy dimensionet e diskriminimit: diskriminimi i bazuar në aftësitë e kufizuara dhe diskriminimi gjinor. Për shembull, vajzat dhe gratë me aftësi të kufizuara mund të përballen me sfida të shumta në qasjen në mundësi të punës, për shkak të barrierave fizike dhe përfshirjes gjinore, si dhe mungesës së mbështetjes për aftësinë e tyre të kufizuar.



Në fushën e arsimit, ligji përcakton se të gjithë individët kanë të drejtë për arsim të barabartë dhe pa diskriminim, duke përfshirë këtu të drejtat e vajzave dhe grave. Ky aspekt është veçanërisht i rëndësishëm për personat me aftësi të kufizuara, të cilët shpesh përballen me barriera të ndryshme për qasje në arsim. Megjithatë, ligji nuk specifikon që institucionet arsimore të marrin masa për të siguruar mbështetje dhe kushte të përshtatshme për nxënësit dhe studentët me aftësi të kufizuara, duke përfshirë edhe ata që përballen me diskriminim gjinor.

Në këtë kontekst, mungesa e detajeve specifike për mekanizmat që do të sigurojnë përfshirjen e plotë të personave me aftësi të kufizuara në sistemin arsimor është një problem. Ligji nuk adreson si duhet ndërveprimin e problemeve të përfshirjes gjinore dhe atyre të përfshirjes për personat me aftësi të kufizuara, duke lënë një boshllëk në trajtimin e vajzave dhe grave me aftësi të kufizuara. Ky boshllëk mund të çojë në mungesë të masave të nevojshme për të garantuar që këta individë të kenë qasje të barabartë në mundësitë arsimore dhe të shfrytëzojnë të drejtat e tyre në përputhje me standardet e barazisë gjinore dhe përfshirjes.

Pavarësisht përpjekjeve për të siguruar barazi gjinore dhe mbrojtjen e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara, ligji ka disa mangësi të rëndësishme që ndikojnë në efikasitetin e tij në këtë drejtim. Një nga mangësitë kryesore është mungesa e detajeve dhe mekanizmave specifike për zbatimin e masave të përmendura në ligj për personat me aftësi të kufizuara.

Ligji i përmend personat me aftësi të kufizuara në një kontekst të përgjithshëm, por nuk ofron udhëzime të qarta dhe të detajuara për institucionet se si të implementojnë këto masa në praktikë. Ky boshllëk është veçanërisht i rëndësishëm kur e konsiderojmë ndërveprimin mes përfshirjes gjinore dhe asaj për personat me aftësi të kufizuara. Ligji nuk ofron mekanizma që

adresojnë nevojat specifike të vajzave dhe grave me aftësi të kufizuara, të cilat shpesh përballen me barrierat më të mëdha për qasje në mundësi dhe shërbime.

Në këtë kontekst, ligji duket se nuk integron në mënyrë të mjaftueshme dimensionin gjinor në përpjekjet për përfshirjen e personave me aftësi të kufizuara. Për shembull, vajzat dhe gratë me aftësi të kufizuara shpesh përballen me një shumëllojshmëri të barrierave që janë të kombinuara të diskriminimit. Këto barrierë përfshijnë, por nuk kufizohen në, mungesën e qasjes në arsim, mundësi të punës dhe shërbime shëndetësore, si dhe mungesën e mbështetjes adekuate për t'u përballur me sfidat e veçanta që ndodhin në kontekstin e kombinuar të diskriminimit gjinor dhe atij për aftësi të kufizuara.

Ligji duhet të ofrojë një qasje më të integruar që të adresojë në mënyrë të barabartë nevojat e të dy grupeve. Kjo do të përfshinte krijimin e mekanizmave që ndihmojnë në identifikimin dhe adresimin e barrierave specifike për vajzat dhe gratë me aftësi të kufizuara, si dhe zhvillimin e politikave që promovojnë një përfshirje më të plotë dhe më të drejtpërdrejtë në sistemin arsimor, në vendin e punës, dhe në shërbimet e tjera publike. Pa këto mekanizma të detajuara dhe të harmonizuara, është e vështirë të sigurohet një përfshirje e plotë dhe efektive për të gjithë individët, pavarësisht nga statusi i tyre gjinor ose aftësitë e tyre.

### **3.2 Ligji Nr. 05/L-067 për Statusin dhe të Drejtat e Personave Paraplegjik dhe Tetraplegjik**

Ligji Nr. 05/L-067 për statusin dhe të drejtat e personave paraplegjik dhe tetraplegjik në Kosovë përbën një hap të rëndësishëm në drejtim të mbrojtjes së të drejtave të personave me aftësi të kufizuara. Megjithatë, për të siguruar një zbatim të drejtë dhe të barabartë, është e nevojshme

që ky legjislacion të analizohet dhe zbatohet nga një perspektivë gjinore. Analiza e Ligjit Nr. 05/L-067 mbi statusin dhe të drejtat e personave me paraplegji dhe tetraplegji në Kosovë nga një perspektivë gjinore shfaq disa çështje kritike dhe fusha për përmirësim:

Ligji i mungojnë dispozita specifike për të siguruar përfaqësimin dhe pjesëmarrjen gjinore të grave me paraplegji ose tetraplegji në proceset vendimmarrëse lidhur me të drejtat dhe politikat e personave me aftësi të kufizuara. Megjithëse ligji përmes Nenit 13<sup>8</sup> synon të sigurojë qasje të barabartë në shërbimet shëndetësore, përfshirë shërbimet mjekësore dhe shëndetin riprodhues, shpesh mungojnë konsideratat specifike gjinore. Gratë me aftësi të kufizuara përballen me pengesa shtesë në qasjen e këtyre shërbimeve për shkak të problemeve të qasjes fizike, mungesës së ofruesve të trajnuar të shërbimeve shëndetësore dhe mungesës së pajisjeve adekuate shëndetësore.<sup>9</sup> Është thelbësore që strukturat shëndetësore të jenë të qasshme dhe të pajisura për të ofruar shërbime të plota shëndetësore riprodhuese të përshtatura për gratë me aftësi të kufizuara. Masat për fuqizimin ekonomik të personave me aftësi të kufizuara nën ligjin në fjalë nuk adresojnë mjaftueshëm dallimet gjinore. Gratë me aftësi të kufizuara shpesh ballafaqohen me diskriminim të theksuar në mundësitë e punësimit, ndarjen e pagesave dhe qasjen në burime financiare. Politika dhe programet specifike duhet të zhvillohen për të promovuar pavarësinë ekonomike tek gratë me paraplegji ose tetraplegji, përfshirë trajnime profesionale, mbështetje për sipërmarrjen dhe ndihmë financiare. Gjithashtu, diskriminimi

---

<sup>8</sup> Ligji Nr. 05/L-067 për Statusin dhe të Drejtat e Personave Paraplegjik dhe Tetraplegjik

<sup>9</sup> “Edhe ne jemi si gratë tjera”

[https://kosovotwopointzero.com/edhe-ne-jemi-si-grate-tjera/?fbclid=IwZXh0bgNhZW0CMTAAR1l44EviZbik3LLK7ispMHyqhSzpdDdL9iMOgqJMZNatY7jTm9NeSXiukc\\_aem\\_42urM7o9Pgs8wEuSB5e8OQ](https://kosovotwopointzero.com/edhe-ne-jemi-si-grate-tjera/?fbclid=IwZXh0bgNhZW0CMTAAR1l44EviZbik3LLK7ispMHyqhSzpdDdL9iMOgqJMZNatY7jTm9NeSXiukc_aem_42urM7o9Pgs8wEuSB5e8OQ)

interseksional që ballafaqohet nga gratë me aftësi të kufizuara, përfshirë ato nga minoritetet etnike ose zonat rurale, nuk adresohet në mënyrë adekuate në ligj. Përfaqësimi i qasjeve interseksionale është i domosdoshëm për të kuptuar se si forma të shumta të diskriminimit kryqëzohen dhe përkeqësojnë pabarazitë.

### **3.3 Ligji Nr. 03/L-019 për aftësimin, riaftësimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara nga një perspektivë gjinore**

Ligji Nr. 03/L-019 rregullon të drejtat, kushtet dhe mënyrat e aftësimin, riaftësimin profesional dhe punësimin të personave me aftësi të kufizuara në Kosovë, duke synuar integrimin e tyre në tregun e punës.<sup>10</sup> Ky ligj përfshin disa nene që adresojnë mbështetjen ligjore dhe institucionale për personat me aftësi të kufizuara dhe promovimin e barazisë së mundësive. Megjithatë, nga një perspektivë gjinore, analizohen disa pika kyçe që mund të përmirësohen për të siguruar barazinë gjinore.

Një aspekt i rëndësishëm që duhet adresuar është ndërveprimi ndërmjet aftësisë së kufizuar dhe gjinisë. Ky ligj nuk adreson në mënyrë specifike sfidat dhe nevojat e grave me aftësi të kufizuara. Duke qenë se gratë me aftësi të kufizuara kanë tendencë të kenë mundësi më të kufizuara në arsimim, aftësim profesional dhe punësim, është e domosdoshme që politika dhe programet e përfshira në këtë ligj të adresojnë këto pabarazi.

---

<sup>10</sup> Ligji Nr. 03/L-019 për aftësimin, riaftësimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara nga një perspektivë gjinore

Ligji duhet të përmbajë dispozita specifike që promovojnë përfshirjen gjinore dhe sigurojnë mbështetje për gratë me aftësi të kufizuara. Për shembull, mund të përfshihen programe të aftësimit dhe riaftësimit profesional për gratë, mbështetje për nënat me aftësi të kufizuara, dhe politika që sigurojnë mbrojtje nga diskriminimi në vendin e punës bazuar në gjini dhe aftësi të kufizuara.

Për më tepër, Komisioni për ekspertizë duhet të ketë një përbërje të balancuar gjinore dhe të trajnohet për të vlerësuar nevojat e ndryshme gjinore në kontekstin e aftësisë së kufizuar. Kjo do të sigurojë që vlerësimet dhe rekomandimet të jenë gjithëpërfshirëse dhe të ndjeshme ndaj gjinisë.

Përderisa Ligji Nr. 03/L-019 është një hap drejt mbështetjes së personave me aftësi të kufizuara, një qasje më gjithëpërfshirëse dhe e ndjeshme ndaj gjinisë është thelbësore për të siguruar që gratë me aftësi të kufizuara të kenë mundësi të barabarta për aftësim, riaftësim profesional dhe punim.

### **3.4 Ligji Nr. 05/L-021 për Mbrojtjen nga Diskriminimi**

Ligji Nr. 05/L-021 synon të mbrojë individët nga diskriminimi në Kosovë. Ai përcakton dispozita të ndryshme për të siguruar trajtim të barabartë për karakteristika të ndryshme, përfshirë aftësitë e kufizuara dhe gjininë.<sup>11</sup> Po ashtu Kosova, i ka të përfshira në nenin 22 të Kushtetutës së

---

<sup>11</sup> Ligji Nr. 05/L-021 për Mbrojtjen nga Diskriminimi <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=10924>

saj, Konventën e Kombeve të Bashkuara për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit Kundër Grave.<sup>12</sup>

Ligji aktual ka nevojë për integrimin e perspektivës gjinore në mënyrë më të detajuar dhe specifike për të siguruar mbrojtjen e barabartë për gratë dhe burrat me aftësi të kufizuara. Për të arritur këtë, duhet të bëhen disa përmirësime kyçe. Së pari, qëllimi i ligjit duhet të theksojë mbrojtjen nga diskriminimi duke marrë parasysh dimensionin gjinor, për të siguruar që nevojat dhe sfidat specifike të grave dhe burrave me aftësi të kufizuara të adresohen në mënyrë të barabartë.

Është e rëndësishme të promovohen masa pozitive specifike për gratë me aftësi të kufizuara, duke përfshirë qasje më të mirë në edukim, punësim dhe shërbime shëndetësore. Këto masa duhet të përfshijnë programe trajnimi, mentorimi dhe mbështetje për fuqizimin ekonomik dhe social të tyre.

Një tjetër aspekt kritik është forcimi i masave mbrojtëse kundër dhunës me bazë gjinore për personat me aftësi të kufizuara. Kjo duhet të përfshijë shërbime mbështetëse për viktimat, programe ndërgjegjësimi dhe trajnime për profesionistët e drejtësisë dhe shërbimeve sociale. Barazia në punësim gjithashtu duhet të promovohet duke kërkuar nga punëdhënësit të zbatojnë politika dhe praktika të barabarta për gratë dhe burrat me aftësi të kufizuara, duke përfshirë akomodimet e nevojshme dhe mundësi të barabarta për zhvillimin e karrierës.

---

<sup>12</sup> Kushtetuta e Republikës së Kosovës (<https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=3702>)

Monitorimi dhe zbatimi i masave të përmirësuara duhet të realizohet përmes krijimit të mekanizmave specifikë, që përfshijnë raportime të rregullta mbi gjendjen e grave dhe burrave me aftësi të kufizuara dhe efektivitetin e politikave të ndërmarra. Përfundimisht, përmirësimi i këtij ligji duhet të synojë adresimin e sfidave të shumëfishta dhe specifike që përballen gratë dhe burrat me aftësi të kufizuara për të siguruar një mbrojtje dhe përfshirje të barabartë në shoqëri.

#### **4. Korniza strategjike, programore si dhe raporte mbi përfshirjen gjinore dhe aspektit të aftësisë së kufizuar**

##### **4.1 Strategjia Kombëtare për Mbrojtje nga Dhuna në Familje dhe Dhuna ndaj Grave 2022 – 2026**

Strategjia Kombëtare për Mbrojtje nga Dhuna në Familje dhe Dhuna ndaj Grave 2022 – 2026 është një dokument që, ndonëse fokusohet kryesisht te dhuna ndaj grave dhe dhuna në familje, gjithashtu përfshin referenca për personat me aftësi të kufizuara. Ky fakt e bën të rëndësishëm pasi trajtimi i çështjeve të dhunës në bazë gjinore dhe në familje është i ndërlidhur me përfshirjen dhe mbrojtjen e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara.

Dokumenti synon të adresojë dhe parandalojë format më të përhapura të dhunës dhe shkeljes së lirive dhe të drejtave themelore të njeriut në Kosovë. Një nga aspektet thelbësore të kësaj strategjie është përfshirja e parimeve që synojnë të adresojnë ndërthurjen e diskriminimit gjinor me forma të tjera të diskriminimit, përfshirë diskriminimin bazuar në aftësinë e kufizuar.<sup>13</sup> Kwtu

---

<sup>13</sup> Strategjia Kombëtare Për Mbrojtje Nga Dhuna Në Familje Dhe Dhuna Ndaj Grave 2022 – 2026

shqyrtohet perspektiva e personave me aftësi të kufizuara dhe atë gjinore, duke theksuar rëndësinë e trajtimit të këtyre çështjeve në mënyrë integruese dhe të ndjeshme ndaj dimensioneve të shumta të diskriminimit.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës, e amenduar në vitin 2020, i njeh zbatim të drejtëpërdrejtë Konventës së Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (“Konventa e Stambollit”), një instrument për parandalimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, si dhe për mbrojtjen e viktimave. Mbrojtja e jetës dhe të jetuarit me dinjitet dhe pa dhunë, garantuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, gjen rregullim edhe në kuadër të Ligjit Nr. 03/L-182 për Mbrojtje nga Dhuna në Familje.

Një nga aspektet kryesore të kësaj strategjie është përfshirja e dispozitave që synojnë të promovojnë barazinë gjinore dhe mbrojtjen e të drejtave të grave në Kosovë. Megjithatë, një nga mangësitë kryesore të këtij dokumenti është mungesa e detajeve specifike dhe mekanizmave të qarta për zbatimin e këtyre masave për personat me aftësi të kufizuara. Edhe pse strategjia përmend në mënyrë të përgjithshme përfshirjen e personave me aftësi të kufizuara, ajo nuk jep udhëzime të qarta për institucionet se si të sigurojnë që këto masa të jenë efektive dhe të zbatohen në praktikë.

Dhuna ndaj grave me aftësi të kufizuara shpesh përfshin forma të ndryshme të diskriminimit dhe abuzimit, që mund të përfshijnë edhe forma specifike të dhunës që lidhen me aftësinë e kufizuar. Gratë me aftësi të kufizuara mund të përballen me abuzim fizik dhe psikologjik, si dhe me

---



neglizhencë dhe shfrytëzim. Këto forma të dhunës shpesh janë të ndërlidhura dhe mund të shkaktojnë dëme të mëdha për viktimat, duke i lënë ato në një pozitë të pafuqishme dhe të varur nga autorët e dhunës.

Një tjetër aspekt i rëndësishëm i Strategjisë Kombëtare për Mbrojtje nga Dhuna në Familje dhe Dhuna ndaj Grave është mungesa e mbështetjes së nevojshme për personat me aftësi të kufizuara për të raportuar dhe adresuar rastet e dhunës. Për shembull, gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara shpesh kanë vështirësi në qasje tek shërbimet e mbrojtjes dhe drejtësisë për shkak të barrierave fizike, komunikative dhe të informacionit. Mungesa e interpretimeve në gjuhën e shenjave, mungesa e qasjes në ndërtesa dhe mungesa e informacionit të qartë dhe të kuptueshëm janë disa nga barrierat që mund të pengojnë gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara të kërkojnë ndihmë dhe mbrojtje.

Strategjia Kombëtare për Mbrojtje nga Dhuna në Familje dhe Dhuna ndaj Grave duhet të përfshijë masa specifike dhe të detajuara për të adresuar këto çështje dhe për të siguruar që gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara të kenë qasje të barabartë në shërbimet e mbrojtjes dhe drejtësisë. Për shembull, është e nevojshme të sigurohet trajnimi i duhur për profesionistët e shëndetësisë, drejtësisë dhe shërbimeve sociale për të kuptuar dhe trajtuar nevojat specifike të grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara. Gjithashtu, është e rëndësishme të krijohen dhe të zbatohet një qasje e integruar që përfshin bashkëpunimin midis institucioneve të ndryshme për të siguruar një mbrojtje efektive dhe gjithëpërfshirëse për këtë grup të prekshëm.

Një tjetër aspekt i rëndësishëm është përfshirja e grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara në procesin e hartimit dhe zbatimit të politikave dhe strategjive për mbrojtjen nga dhuna. Është e

rëndësishme të krijohen mekanizma që sigurojnë përfshirjen aktive të këtij grupi në proceset vendimmarrëse dhe të sigurohen që zërat e tyre të dëgjohen dhe të respektohen. Kjo mund të përfshijë krijimin e forumeve të konsultimit, grupet e punës dhe mekanizmat e raportimit që lejojnë gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara të kontribuojnë në hartimin dhe zbatimin e politikave dhe strategjive për mbrojtjen nga dhuna.

Strategjia Kombëtare për Mbrojtje nga Dhuna në Familje dhe Dhuna ndaj Grave 2022 – 2026 është një dokument i rëndësishëm që synon të adresojë dhe parandalojë format më të përhapura të dhunës dhe shkeljes së lirive dhe të drejtave themelore të njeriut në Kosovë. Megjithatë, për të qenë efektive dhe gjithëpërfshirëse, kjo strategji duhet të përfshijë masa specifike dhe të detajuara për të adresuar nevojat dhe sfidat e grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara, duke siguruar që ato të kenë qasje të barabartë në shërbimet e mbrojtjes dhe drejtësisë. Një qasje e integruar dhe gjithëpërfshirëse që merr parasysh dimensionet e shumta të diskriminimit është thelbësore për të siguruar mbrojtjen dhe përparimin e këtij grupi të prekshëm dhe për të arritur një barazi dhe siguri gjithëpërfshirëse.

#### **4.2 Programi i Kosovës për Barazi Gjinore 2020-2024**

Programi i Kosovës për Barazi Gjinore 2020-2024 synon të sigurojë që barazia gjinore është në qendër të proceseve transformuese në Kosovë, në kuadër të të gjitha strukturave, institucioneve, politikave, procedurave, praktikave dhe programeve të qeverisë, agjencive, shoqërisë civile,

sektorit privat dhe komunitetit të donatorëve.<sup>14</sup> Ky program është pesëvjeçar dhe përfshin periudhën 2020-2024. Programi është i organizuar në tre shtylla strategjike: Fuqizimi Ekonomik dhe Mirëqenia Sociale; Zhvillimi Njerëzor, Rolet dhe Marrëdhëniet Gjinore; dhe të Drejtat e Grave, Qasja në Drejtësi dhe Siguria. Një nga aspektet kryesore të këtij programi është përfshirja dhe adresimi i çështjeve të personave me aftësi të kufizuara, sidomos nga perspektiva gjinore, duke theksuar rëndësinë e krijimit të mundësive të barabarta për të gjithë qytetarët e Kosovës.

Një nga problemet kryesore në shtyllën e Fuqizimit Ekonomik dhe Mirëqenies Sociale bazuar në situatën aktuale në Kosovë është prania e pabarazive dhe përjashtimi socio-ekonomiko-strukturor. Faktorët kryesorë që ndikojnë në këtë problem janë: mungesa e integritimit gjinor në strategji dhe politikat zhvillimore; mos zbatimi i buxhetimit të përgjegjshëm gjinor; diskriminimi në punësim; niveli i ulët i shkollimit të grave në moshë pune (15-64); ndarja e profesioneve gjinore; ndarja e pabarabartë e obligimeve për përkujdesjen e fëmijëve dhe të moshuarve; pjesëmarrje e ulët e grave në menaxhimin e burimeve; mungesa e institucioneve për përkujdesjen e fëmijëve; dhe qasja e kufizuar në të drejtat pronësore dhe financa. Në Kosovë, edhe më shumë se në vende të tjera, gratë mbulojnë shërbime të konsiderueshme pa pagesë, si kujdesi për fëmijë, të moshuar dhe anëtarë të familjes me aftësi të kufizuara. Këto sfida janë veçanërisht edhe më të theksuara për gratë me aftësi të kufizuara, të cilat përballen me diskriminim të dyfishtë, si në bazë të gjinisë ashtu edhe të aftësisë së kufizuar.

---

<sup>14</sup> Programi i Kosovës për Barazi Gjinore 2020-2024

Objektivi Strategjik 1 synon krijimin e mundësive të barabarta për të kontribuar dhe përfituar nga zhvillimi ekonomik, rritjen e gjithë përfshirjes dhe përmirësimin e mirëqenies sociale. Për të arritur këtë objektiv, programi parashikon ngritjen e shkathtësive të grave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke u fokusuar edhe në fushat deficitare dhe adresimin e diskriminimit në baza gjinore në punësim, përmes ndryshimit të Ligjit të Punës, për të garantuar pushimin të barabartë prindëror dhe direktivat e BE-së. Një nga masat e rëndësishme është ofrimi i qasjes së barabartë në shërbime sociale dhe familjare cilësore, përfshirë qendra rezidenciale për përkujdesje ditore për të moshuar dhe persona me aftësi të kufizuara, duke lehtësuar kështu mundësitë e grave për t'u aktivizuar në tregun e punës.

Në Kosovë ekzistojnë pesë Qendra Burimore dhe dy shkolla për fëmijët me aftësi të kufizuara. Megjithatë, më shumë djem (59%) sesa vajza (41%) me aftësi të kufizuara vijojnë arsimin e detyrueshëm. Sfidat për edukimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara përfshijnë thyerjen e stigmës shoqërore rreth aftësisë së kufizuar në mënyrë që prindërit t'i edukojnë fëmijët e tyre.<sup>15</sup> Të dhënat tregojnë se vajzat me aftësi të kufizuara përballen me diskriminim të dyfishtë në fushën e edukimit në krahasim me djemtë.<sup>16</sup> Për shembull, shkalla bruto e përfshirjes së vajzave me aftësi të kufizuara në nivelet e arsimit fillor dhe të mesëm të ulët është 37%, ndërsa në arsimin e mesëm të lartë bie në 18%. Ky fakt tregon për nevojën e masave specifike për të përmirësuar përfshirjen e vajzave me aftësi të kufizuara në sistemin arsimor.

---

<sup>15</sup> Analizë gjinore e Kosovë, Rrjeti i grave të Kosovës, <https://womensnetwork.org/wp-content/uploads/2018/10/20181003170921410.pdf>

<sup>16</sup> Analiza Gjinore Ndersektorale ne Arsimin Parauniversitar, Projekti i Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës "Ngritja e Kapacitetit për Arsim Gjithëpërfshirës - INCLUDE".

Gratë në grupet minoritare dhe me aftësi të kufizuara po ashtu përballen me sfida më të theksuara ekonomike, sociale dhe kulturore. Për shembull, gratë Rome, Ashkali dhe Egjiptase përballen me diskriminime të trefishta, meqë diskriminohen nga familjet e tyre, nga komunitetet e tjera në shumicë si dhe nga institucionet e nivelit qendror. Gratë me aftësi të kufizuara po ashtu diskriminohen më shumë, për shkak të sfidave në zbatimin praktik të ligjeve dhe ofrimin e mjeteve juridike efektive, pavarësisht kërkesave ligjore të garantuara me Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe Ligjin për Barazi Gjinore.

Një nga rekomandimet kryesore është amandamentimi i Kushtetutës së Kosovës për të përfshirë Konventën Ndërkombëtare për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, Konventën mbi të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara dhe Kartën Sociale të Evropës, në mënyrë që të jenë drejtpërdrejt të aplikueshme në ligjin vendor. Ky veprim do të siguronte që personat me aftësi të kufizuara dhe gratë të kenë mbrojtje të barabartë dhe të drejtë.

Programi i Kosovës për Barazi Gjinore 2020-2024 është një dokument i rëndësishëm që synon të adresojë dhe parandalojë format e ndryshme të diskriminimit dhe përjashtimit social. Megjithatë, për të qenë efektiv dhe gjithëpërfshirës, programi duhet të përfshijë masa specifike dhe të detajuara për të adresuar nevojat dhe sfidat e personave me aftësi të kufizuara, veçanërisht nga perspektiva gjinore. Një qasje e integruar dhe gjithëpërfshirëse që merr parasysh dimensionet e shumta të diskriminimit është thelbësore për të siguruar barazinë dhe përparimin e këtij grupi të prekshëm dhe për të arritur një shoqëri më të drejtë dhe gjithëpërfshirëse.

### **4.3 Programi i Qëndrueshëm për Zhvillimin e Kombeve të Bashkuara 2030 (SDG 2030) në Kosovë dhe Perspektiva Gjinore dhe e Personave me Aftësi të Kufizuara**

Kosova ka adoptuar Agjendën 2030 dhe Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDG-të) përmes një rezolute parlamentare në janar 2018, duke treguar përkushtimin e saj për zhvillim të qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës. Megjithatë, ndonëse nuk është nënshkruese e drejtpërdrejtë e SDG-ve për shkak të statusit të saj si një vend jo-anëtar i OKB-së, Kosova ka marrë vendimin për t'u bashkuar me përpjekjet globale për të përqaftuar këto qëllime. Kjo analizë fokusohet në perspektivën gjinore dhe të personave me aftësi të kufizuara, duke vlerësuar se si Kosova mund të kontribuojë në arritjen e SDG-ve dhe cilat objektiva janë të lidhura me këto grupe.

#### **SDG 1 - Pa Varfëri**

Në Kosovë, varfëria mbetet një problem i rëndësishëm, veçanërisht për personat me aftësi të kufizuara dhe gratë. Këto grupe shpesh përballen me një nivel të lartë të diskriminimit dhe mungesë të mundësive për punësim, duke kontribuar në varfëri të thellë. Për të luftuar varfërinë në mesin e këtyre grupeve, Kosova duhet të zhvillojë dhe zbatojë politika të veçanta që mbështesin qasjen në arsim dhe punësim për personat me aftësi të kufizuara dhe gratë. Kjo përfshin ofrimin e trajnimeve profesionale dhe subvencioneve për ndërmarrjet që i punësojnë këta individë, duke krijuar kështu mundësi të barabarta dhe ndihmuar në uljen e varfërisë.

### **SDG 3 - Shëndet i Mirë dhe Mirëqenie**

Qasja në shërbime shëndetësore cilësore është një tjetër sfidë e madhe në Kosovë, veçanërisht për personat me aftësi të kufizuara dhe gratë. Shërbimet shëndetësore dhe rehabilituese janë të kufizuara, duke ndikuar negativisht në mirëqenien e këtyre grupeve. Për të përmirësuar situatën, është thelbësore që Kosova të rrisë investimet në shërbimet shëndetësore dhe të sigurojë trajnimin e duhur për profesionistët e shëndetësisë, që të mund të trajtojnë në mënyrë gjithëpërfshirëse dhe profesionale nevojat specifike të personave me aftësi të kufizuara dhe grave. Kjo do të ndihmojë në përmirësimin e mirëqenies së tyre dhe në sigurimin e një jetese më të shëndetshme.

### **SDG 4 - Arsim Cilësor**

Arsimi për personat me aftësi të kufizuara dhe gratë është i kufizuar në shumë aspekte në Kosovë. Infrastruktura jo e përshtatshme dhe mungesa e mbështetjes së duhur pengojnë qasjen e barabartë në arsim. Për të adresuar këto çështje, Kosova duhet të zhvillojë politika arsimore gjithëpërfshirëse që sigurojnë qasje të barabartë për të gjithë fëmijët. Kjo përfshin adaptimin e infrastrukturës dhe materialeve mësimore për të përmbushur nevojat e ndryshme, duke krijuar një mjedis arsimor që është i arritshëm për të gjithë nxënësit, pavarësisht nga aftësitë e tyre fizike apo gjinia.

### **SDG 5 - Barazia Gjinore**

Barazia gjinore mbetet një sfidë e madhe në Kosovë, veçanërisht për gratë me aftësi të kufizuara. Këto gra përballen me pabarazi të shumta, duke përfshirë diskriminimin dhe mungesën e

mundësive për të marrë pjesë në vendimmarrje. Për të arritur barazinë gjinore, Kosova duhet të zbatojë politika të fuqizimit të grave dhe vajzave, duke promovuar pjesëmarrjen e tyre në të gjitha fushat e jetës dhe mbrojtjen e të drejtave të tyre. Kjo përfshin krijimin e mundësive për edukim, punësim dhe përfshirje aktive në proceset vendimmarrëse, duke siguruar që gratë me aftësi të kufizuara të kenë të njëjtat mundësi si të gjithë të tjerët.

### **SDG 8 - Punë Dinjitoze dhe Rritje Ekonomike**

Personat me aftësi të kufizuara dhe gratë shpesh përballen me pengesa të mëdha në tregun e punës në Kosovë. Mungesa e mundësive për punësim dhe diskriminimi janë disa nga faktorët që ndikojnë në këtë gjendje. Për të përmirësuar qasjen e këtyre grupeve në tregun e punës, Kosova duhet të krijojë programe të trajnimit dhe zhvillimit profesional që janë të përshtatura për nevojat e tyre. Për më tepër, nxitja e politikave të barazisë në punësim është thelbësore për të siguruar mundësi të barabarta për të gjithë, duke kontribuar kështu në rritjen ekonomike dhe mirëqenien e të gjithë qytetarëve.

### **SDG 10 - Zvogëlim i Pabarazive**

Pabarazitë sociale dhe ekonomike janë të pranishme në shumë aspekte të jetës në Kosovë, veçanërisht për personat me aftësi të kufizuara dhe gratë. Për të reduktuar këto pabarazi, është e nevojshme që Kosova të zhvillojë politika që mbrojnë të drejtat e këtyre grupeve dhe të sigurojë që ata të kenë qasje të barabartë në të gjitha fushat e jetës. Kjo përfshin qasjen në arsim, shëndetësi, punësim dhe pjesëmarrje në vendimmarrje, duke krijuar një shoqëri më gjithëpërfshirëse dhe të drejtë.



## **SDG 16 - Paqe, Drejtësi dhe Institucione të Forta**

Në Kosovë, ndërtimi i institucioneve që janë më gjithëpërfshirëse dhe të drejta për të gjithë qytetarët është një sfidë e rëndësishme. Personat me aftësi të kufizuara dhe gratë shpesh përballen me pengesa në qasjen në drejtësi dhe në përfaqësimin e tyre në institucionet publike. Për të ndërtuar një shoqëri të drejtë dhe gjithëpërfshirëse, Kosova duhet të forcojë institucionet ligjore dhe administrative për të mbrojtur të drejtat e të gjithë qytetarëve. Kjo përfshin sigurimin e qasjes së barabartë në drejtësi dhe krijimin e mekanizmave që mbrojnë dhe promovojnë të drejtat e personave me aftësi të kufizuara dhe grave.

## **SDG 17 - Partneritet për Objektivat**

Për të arritur qëllimet e SDG 2030, bashkëpunimi ndërmjet qeverisë, OJQ-ve dhe komunitetit ndërkombëtar është i rëndësishëm. Kosova duhet të promovojë partneritete efektive dhe gjithëpërfshirëse që mbështesin zhvillimin e qëndrueshëm dhe përfshirjen sociale për të gjithë qytetarët. Kjo përfshin krijimin e bashkëpunimeve strategjike që mbështesin zbatimin e politikave të orientuara drejt përfshirjes dhe barazisë, duke kontribuar kështu në ndërtimin e një shoqërie më të drejtë dhe gjithëpërfshirëse.

Në përfundim, duke marrë hapa konkretë për të adresuar sfidat dhe për të përmirësuar përfshirjen dhe barazinë, Kosova mund të përmbushë qëllimet e SDG 2030 dhe të krijojë një shoqëri më të drejtë dhe gjithëpërfshirëse për të gjithë qytetarët e saj. Fokusi në perspektivën gjinore dhe të personave me aftësi të kufizuara është kyç për arritjen e këtyre objektivave dhe përmirësimin e cilësisë së jetës për këto grupe vulnerabile.

#### 4.4 RAPORTI I PROGRESIT PËR KOSOVËN 2023

Raporti i Progresit për Kosovën 2023 zbërthen disa aspekte kyçe të integritit dhe përfshirjes së personave me aftësi të kufizuara (PAK) dhe barazisë gjinore në vend. Ndërsa Kosova ka bërë përpjekje të dukshme për të përmirësuar këto fusha, raporti nënvizon se ka ende sfida të konsiderueshme që kërkojnë angazhim të vazhdueshëm dhe veprime konkrete.<sup>17</sup>

Një nga çështjet më shqetësuese të evidentuara në raport është mungesa e qasjes në shërbime dhe infrastrukturë për PAK. Ky problem ndikon drejtpërdrejt në cilësinë e jetës së tyre dhe përfshirjen e plotë në shoqëri. Mungesa e qasjes në kujdesin shëndetësor, rehabilitim, shërbime sociale, arsim dhe pajisje ndihmëse është e dukshme dhe përbën një barrierë të rëndësishme.

Raporti thekson se, edhe pse ekziston një udhëzim administrativ për qasjen e PAK, zbatimi i tij është i dobët. Diskriminimi i drejtpërdrejtë ka qenë i dokumentuar në vendime gjyqësore, dhe ka patur raste ku individë me aftësi të kufizuara kanë ngritur padi për diskriminim, duke vërtetuar kështu një boshllëk të theksuar në implementimin e ligjeve dhe në përputhshmërinë me standardet ndërkombëtare.

Përpjekjet e qeverisë në vitin 2022, e shpallur si vit i personave me aftësi të kufizuara, përfshinin disa iniciativa për të përmirësuar qasjen në institucionet qendrore dhe lokale. Megjithatë, ka

---

<sup>17</sup> Raporti për Kosovën 2023, [https://integrimievropian.rks-gov.net/wp-content/uploads/2023/12/Kosovo-2023-Report\\_SQ.pdf](https://integrimievropian.rks-gov.net/wp-content/uploads/2023/12/Kosovo-2023-Report_SQ.pdf)

nevojë për përpjekje të mëtejshme për të rritur përfshirjen dhe për të siguruar një zbatim më të plotë të ligjeve dhe standardeve ndërkombëtare.

Për të përmirësuar situatën, raporti rekomandon forcimin e shërbimeve shëndetësore për PAK, me fokus të veçantë në gratë dhe vajzat. Gjithashtu, është e nevojshme të rritet përdorimi i formave të ndryshme të konsultimit publik dhe të intensifikohen përpjekjet për zbatimin e ligjeve që ndihmojnë në përmirësimin e kushteve të jetesës për PAK.

Në lidhje me barazinë gjinore, Raporti i Progresit për Kosovën 2023 zbulon disa përparime, por edhe sfida të mëdha. Gratë vazhdojnë të përballen me diskriminim në administratën publike, tregun e punës, dhe sistemin e drejtësisë. Ky diskriminim përfshin vështirësi në qasje në financa, pronësi dhe trajtim në sistemin e drejtësisë, duke kërkuar ndërhyrje të menjëhershme për të adresuar këto çështje.

Në raport, theksohet se Ligji për Barazi Gjinore është përpjekur të forcohet, por ende ka mangësi në zbatimin e tij.

Shoqëria civile luan një rol të rëndësishëm në avokimin për të drejtat e grave dhe për barazinë gjinore. Ajo kontribuon në hartimin, zbatimin dhe monitorimin e reformave dhe është një partner kyç në dialogun politik të Stabilizim-Asociimit.

Raporti gjithashtu vë në dukje përmirësimet në platformën online për konsultime publike, që kanë lehtësuar pjesëmarrjen e personave me aftësi të kufizuara. Megjithatë, përfshirja e publikut në agjendat e reformave mbetet e kufizuar dhe duhet të përmirësohet. Rekomandohet rritja e

përdorimit të formave të ndryshme të konsultimit publik dhe angazhimi më i madh i administratave lokale.

Raporti i Progresit për Kosovën 2023 tregon disa përparime në fushën e barazisë gjinore dhe integritit të PAK, por ka ende shumë sfida që kërkojnë angazhim dhe veprime të vazhdueshme. Kosova duhet të intensifikojë përpjekjet për të arritur një shoqëri më të barabartë dhe gjithëpërfshirëse, duke siguruar që çdo individ, pavarësisht nga gjinia apo aftësitë e kufizuara, të ketë mundësi të barabarta dhe të trajtohet me dinjitet.

## 5. Të gjeturat

- Ligji që trajton barazinë gjinore nuk përfshinë masa specifike për sigurimin e mundësive të barabarta në punësim dhe trajnime për individët me aftësi të kufizuara;
- Gratë me aftësi të kufizuara përballen me barrierat e dyfishta të diskriminimit, që përfshijnë barrierat fizike dhe diskriminimin gjinor;
- Politikat dhe programet specifike për të promovuar pavarësinë ekonomike tek gratë me paraplegji ose tetraplegji, përfshirë trajnime profesionale, mbështetje për sipërmarrjen dhe ndihmë financiare, janë të mangëta;
- Me legjislacionin e Kosovës nuk trajtohet në mënyrë të detajuar qasja e barabartë në shërbimet shëndetësore për gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara, duke lënë një boshllëk në sigurinë dhe mbështetje për shëndetin e tyre;
- Shumë nga aktet ligjore nuk ofrojnë udhëzime të plota për adresimin e diskriminimit të dyfishtë për gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara, veçanërisht në qasjen në mundësi edukative dhe trajnuese;

- Aktet ligjore për personat me paraplegji ose tetraplegji nuk ofrojnë masa për të siguruar përfaqësim të barabartë gjinor në proceset e vendimmarrjes dhe mbështetje ekonomike për gratë në këtë grup;
- Politikat për mbrojtjen nga diskriminimi shpesh nuk përfshijnë masa të detajuara për të mbrojtur gratë me aftësi të kufizuara nga dhuna dhe diskriminimi, dhe mungojnë mekanizma të posaçëm për të adresuar këto çështje në mënyrë efektive;
- Politikat aktuale nuk trajtojnë në mënyrë adekuate nevojat ekonomike të grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara, veçanërisht në kontekstin e ndihmës sociale dhe mbështetjes financiare;
- Shumë nga strategjitë dhe ligjet nuk ofrojnë mekanizma të qartë për monitorimin dhe raportimin mbi statusin dhe efektivitetin e politikave për personat me aftësi të kufizuara, veçanërisht në kontekstin e barazisë gjinore;
- Strategjia Kombëtare për Mbrojtje nga Dhuna në Familje dhe Dhuna ndaj Grave 2022 – 2026 nuk përfshin trajnime të duhura për profesionistët e shëndetësisë, drejtësisë dhe shërbimeve sociale për të kuptuar dhe trajtuar nevojat specifike të grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara;
- Mungon përfshirja e aktive e grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara në proceset e hartimit dhe zbatimit të politikave dhe strategjive për mbrojtjen nga dhuna, duke penguar që zërat e tyre të dëgjohen dhe të respektohen;
- Buxhetimi i përgjegjshëm gjinor nuk është implementuar në mënyrë efektive, duke kontribuar në mungesën e mundësive të barabarta për gratë me aftësi të kufizuara.

## 6. Rekomandimet

- Ligji për Barazi Gjinore në Kosovë duhet të integrojë dispozita dhe mekanizma të qartë për të siguruar përfshirjen e personave me aftësi të kufizuara në të gjitha aspektet e jetës publike dhe private, duke adresuar nevojat e grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara;
- Duhet të krijohen udhëzime dhe mekanizma të detajuar për zbatimin e masave që promovojnë barazinë gjinore dhe përfshirjen e personave me aftësi të kufizuara në arsim, punësim dhe shërbime të tjera;
- Kushtetuta e Kosovës duhet të amandamentohet dhe të përfshijë Konventën Ndërkombëtare për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, Konventën mbi të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara dhe Kartën Sociale të Evropës në mënyrë që të jenë drejtpërdrejt të aplikueshme në ligjin vendor në Kosovë;
- Profesionistët dhe institucionet duhet të trajnohen dhe të ndërgjegjësohen për nevojat dhe sfidat e veçanta të grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara;
- Ligji për Statusin dhe të Drejtat e Personave Paraplegjik dhe Tetraplegjik duhet të përfshijë dispozita që sigurojnë përfaqësimin e grave me paraplegji dhe tetraplegji në proceset vendimmarrëse dhe politikat që i prekin ato;
- Duhet të sigurohet që shërbimet shëndetësore, përfshirë ato riprodhuese, të jenë të qasshme dhe të përshtatshme për gratë me aftësi të kufizuara;
- Politikat dhe programet duhet të adresojnë specifikisht nevojat ekonomike të grave me paraplegji dhe tetraplegji, duke përfshirë trajnime profesionale dhe mbështetje për sipërmarrjen;

- Duhet të adresohet diskriminimi që ndikon në gratë me aftësi të kufizuara nga minoritetet etnike ose zonat rurale të cilat ballafaqohen me diskriminim të trefishtë - që janë gra, minoritete dhe me aftësi të kufizuara;
- Duhet të zhvillohen programe specifike që promovojnë përfshirjen e grave me aftësi të kufizuara dhe mbështetje për nënat me aftësi të kufizuara;
- Ligji Nr. 05/L-021 për Mbrojtjen nga Diskriminimi duhet të përmirësojë integrimin e perspektivës gjinore dhe të adresojë diskriminimin e shumëfishtë për gratë me aftësi të kufizuara.
- Duhet të forcohen masat mbrojtëse kundër dhunës me bazë gjinore për personat me aftësi të kufizuara, duke përfshirë shërbime mbështetëse dhe trajnime për profesionistët;
- Në kuadër të Strategjisë Kombëtare për Mbrojtje nga Dhuna në Familje dhe Dhuna ndaj Grave duhet të përfshihen masa të detajuara për të adresuar dhunën ndaj grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara dhe barrierat që ato përballen në raportimin dhe marrjen e ndihmës;
- Profesionistët e shëndetësisë, drejtësisë dhe shërbimeve sociale duhet të trajnohen për të kuptuar dhe trajtuar nevojat specifike të grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara.
- Duhet të forcohet implementimi i buxhetimit të përgjegjshëm gjinor për të kontribuar në krijimin e mundësive të barabarta për gratë me aftësi të kufizuara.

## Referencat

- Plani i Veprimit Gjinor III – 2021-2025 Plani i Zbatimit në Nivel Vendi për Kosovën, ZYRA E BASHKIMIT EVROPIAN NË KOSOVË

- Përfshirja e perspektivës gjinore në praktikë -Udhëzues, Qendra Kosovare për Studime Gjinore, me përkrahje të projektit "Përkrahje Partnerëve Social", i mbështetur nga BE;
- Manuali për vlerësimin e ndikimit të barazisë gjinore, Agjencia për Barazi Gjinore, Projekti “Forcimi institucional i Agjencisë për Barazi Gjinore dhe mekanizmave gjinore në Kosovë
- Analiza Gjinore e Kosovës, Rrjeti i Grave të Kosovës
- Këndvështrim i burrave mbi barazinë gjinore në Kosovë, realizuar nga OSBE dhe Zyra në Kosovë të Fondit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara mbi Popullsinë (UNFPA);
- Qëndrimet e të rinjve ndaj normave gjinore dhe shoqërore, zhvillimit dhe sigurisë njerëzore në Kosovë, Instituti Riinvest për Programin për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara (UNDP);
- Analiza Gjinore Ndersektorale ne Arsimin Parauniversitar, Projekti i Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës “Ngritja e Kapacitetit për Arsim Gjithëpërfshirës - INCLUDE”.
- Strategjia Kombëtare për Mbrojtje nga Dhuna në Familje dhe Dhuna ndaj Grave 2022 – 2026, Ministria e Drejtësisë
- Programi i Kosovës për Barazi Gjinore 2020-2024, ZYRA E KRYEMINISTRIT, AGJENCIA PËR BARAZI GJINORE
- Ligji Nr. 05/L-020 për Barazi Gjinore në Kosovë
- Ligji Nr. 05/L-067 për Statusin dhe të Drejtat e Personave Paraplegjik dhe Tetraplegjik
- Ligji Nr. 03/L-019 për aftësimin, riaftësimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara nga një perspektivë gjinore
- Ligji Nr. 05/L-021 për Mbrojtjen nga Diskriminimi
- Programi i Qëndrueshëm për Zhvillimin e Kombeve të Bashkuara 2030 (SDG 2030), UN